

**Buxheti: 10.490 mld Lekë me TVSH**

**Kohëzgjatja: 2017 – 2022**

**Financues: Fondi Kuvajtian 77% të vlerës, dhe Qeveria Shqiptare 23% të vlerës +TVSH.**

**Shtrirja gjeografike: Qarku Vlorë, Lugina e Lumit të Vlorës, 3 bashki (Vlorë, Selenicë, Himarë);**

**Përfitues: 129 mijë banorë**

**Objektivi i Projektit: Projekti parashikon ti japë zgjidhje të qëndrueshme infrastrukturës publike në zonën e Bregdetit të Jugut, specifikisht në zonën e Lumit të Vlorës, duke kontribuar në përmirësimin e kushteve të jetesës për banorët dhe ridimensionim e sektorit të turizmit si një nga shtyllat kryesore të ekonomisë lokale dhe rajonale.**

### **Konteksti**

**Infrastruktura publike aktualisht nuk favorizon zhvillimin e ekonomisë dhe nuk ofron shërbime optimale për popullsinë vendase dhe turistët që frekuentojnë këtë zonë. Projekti ka si qëllim rikonstruksionin e rrugës së Lumit të Vlorës, e cila mundëson lidhjen e kësaj zone me bregdetin jonian dhe rivierën shqiptare.**

### **Impakti**

**Projekti ka rëndësi të veçantë për zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e kushteve të jetesës të banorëve dhe zonës, ku përfitimet janë si më poshtë:**

- **Lehtësi dhe siguri për levizjen pasi rruga është e kalueshme gjatë gjithë vitit dhe ka rritje trafiku 200% gjatë sezonit të verës;**
- **Mundësi alternative transporti dhe redukton kohën e lëvizjes**
- **Lidhje me tregjet rajonale dhe lokale për tregëtimin e produkteve lokale**
- **Përmirësim i ndërveprimit social dhe akses në aktivitet sociale por edhe shërbimet bazë**
- **Diversifikimi i ekonomisë lokale**
- **Rritja e mundësive për iniciativa të reja dhe punësim**